

02

UDHËZUES XHEPI
PËR SIGURINË

Trajtimi i sigurt
i bombulave të
gazit

MESSER 
Gases for Life



I nderuar konsumator i gazeve Messer,

Messer prodhon dhe furnizon një gamë të gjerë gazesh në bombula.

Bombulat e gazit konsiderohen si pajisje portative me presion; ato paraqesin rreziqe të caktuara që duhet të merren parasysh, dhe ato duhet të trajtohen me kujdes. Bombulat e gazit janë të rënda dhe, në varësi të madhësisë së tyre, janë të vështira për t'u përdorur.

Ky udhëzues xhepi ka për qëllim t'ju informojë në lidhje me masat themelore paraprake që duhet të merren parasysh kur trajtoni bombula gazi nën presion.

Trajtimi këtu i referohet një metode ose veprimtarie mekanike të thjeshtë ose manuale me anë të së cilës lëvizen ose transportohen bombulat individualë të gazit.

Ju lutemi rruani këtë broshurë në mënyrë që ta aksesoni lehtë në çdo kohë.

E rëndësishme

Me çdo produkt, Messer ju siguron një fletë të dhënash sigurie që përmban udhëzime të rëndësishme sigurie mbi gazet. Ju lutemi të njiheni me këtë informacion.

Grupi Juaj Messer



Bombula e gazit

Një bombul gazit është një enë gazit, e rimbushëshme nën presion, që përdoret për transportin dhe ruajtjen e gazeve; ajo zakonisht ka një kapacitet prej tre deri në 60 litra të mbajtur me një **presion** deri në 300 bar.

Rreziqet kryesore

Bombulat e gazit janë të rënda sepse janë prej metali dhe duhet t'i rezistojnë presionit të lartë. Për më tepër, për shkak të formës së tyre të gjatë dhe të ngushtë ato janë të paqëndrueshme kur qëndrojnë në këmbë dhe mund të rrëzohen nëse nuk sigurohen. Ato përmbajnë gaze nën presion të cilat kanë veti të caktuara. Kjo ofron avantazhe, por gjithashtu shkakton rreziqe.

Bombulat e gazit janë shumë më të rënda se sa duken.

Marrja e bombulave të gazit

Sigurohuni që bombula të ketë etiketën e cila është lehtësisht e lexueshme. Nëse etiketa është e palexueshme ose mungon, mos e përdorni këtë bombul gazit.

Ktheni bombulën e gazit për një bombul me një etiketë që është në gjendje të mirë.

Sigurohuni që emri i gazit në etiketën e bombulës të përputhet me porosinë tuaj.

Si një përdorues i ri, duhet të pajiseni me **fletën** përkatëse të **të dhënave të sigurisë (FDS)** që përmban udhëzime të mëtejshme të sigurisë për gazin që keni marrë.

Kontrolloni numrin UN (numrin material) për të parë nëse përputhet me numrin UN në FDS dhe në fletën e dorëzimit.



Informohuni mbi:

- vetitë e gazeve dhe rreziqet që lidhen me to
- fletën e të dhënave të sigurisë
- transportin e sigurt, ngarkimin dhe shkarkimin e bombulave të gazit
- magazinimin e sigurt të bombulave të gazit
- përdorimin e sigurt të bombulave të gazit dhe pajisjeve përkatëse
- masat e emergjencës

Siguria e përgjithshme

Kushtojini vëmendje rreziqeve të mundshme në mjedisin tuaj të punës që mund ta bëjnë të rrezikshëm përdorimin e bombulës së gazit.

Përdorni pajisje të përshtatshme për mbrojtjen personale, të tilla si doreza dhe këpucë sigurie.

Sigurohuni që të keni një kontrol te plot të zbatimit të zinxhirit të sigurisë.

Mos punoni me bombula gazi nëse jeni të lodhur, të dëmtuar fizikisht ose nën ndikimin e ilaçeve, alkoolit ose narkotikëve.



Informacion kryesor mbi trajtimin e bombulave të gazit

Magazinoni bombulat e gazit në temperatura normale të ambientit.

Nxehtësia e tepërt do të bëjë që presioni i brendshëm të rritet dhe mund të ndikojë negativisht në fuqinë e bombulës së gazit. Në raste ekstreme, bombula e gazit mund të shpërthejë. Asnjëherë mos i drejtoni bombulës një pinc saldimit ose ndonjë burim tjetër zjarri.

Përdorni bombulat e gazit me kujdes dhe shmangni çdo lloj dëmtimi që mund të rezultojë nga ndikimet e jashtme. Mos i hidhni bombulat nga automjetet ose rampat kur ngarkoni ose shkarkoni. Bombula ose ventili i bombulës mund të dëmtohet, gjë që mund të shkaktojë rrjedhje të gazit. Kujdesuni që asnjë send i rëndë të mos bjerë mbi bombulat. Gropat që mund të shkaktohen nga goditjet mund të zvogëlojnë fuqinë e mureve të enës, gjë që mund të çojë në dëmtim të parakohshëm të materialit dhe, përfundimisht, të shkaktojë shpërthimin e bombulës.

Qëndroni larg pajisjeve të saldimit elektrik, metalit të ndezur dhe burimeve të tjera të nxehtësisë. Mbani gjithmonë një distancë të sigurt midis bombulës së gazit dhe pincit të saldimit. Çdo harkim midis mjetit dhe bombulës së gazit mund të rezultojë në mbinxhje të lokalizuar të murit të bombulës së gazit.

Mbani bombulën e gazit dhe ventilin e bombulës të pastra. Mos lejoni që bombula e gazit ose ventili i bombulës të vijin **në kontakt me vaj ose yndyra.**

Etiketat që janë ngjitur në bombulën e gazit për ruajtje të përhershme përmbajnë informacione të rëndësishme në lidhje me prodhimin, përdorimin dhe certifikimin e saj. Këto të dhëna nuk duhet të ndryshohen apo të dëmtohen asnjëherë.

Mos provoni asnjëherë të rregulloni ose pikturoni një bombulë gazi. Një bombulë e dëmtuar nuk është e sigurt për t'u përdorur. **Klasifikoni bombulat e dëmtuara dhe vëndosni një shënim të qartë mbi ato.** Informoni Messer-in dhe bëni një kontroll të plotë të bombulës së gazit. Mos mbani të fshehtë ose mos neglizhoni asnjëherë të përmendni dëmtimin e një bombule gazi. Kjo do të rrezikonte sigurinë tuaj dhe sigurinë e të tjerëve dhe mund të ketë pasoja ligjore.

Përdorni bombulat e gazit vetëm me pajisje që janë të pastra dhe në gjendje të mirë.

Bombulat e gazit janë të destinuara për t'u përdorur si enë shkarkimi të gazit. Mos provoni asnjëherë të rimbushni bombulat e gazit, pavarësisht nga gazi që përdoret.

Ato bombula gazi që janë bosh, ose që u ka skaduar data e inspektimit, duhet të kthehen te shoqëria Messer. Mos hidhni asnjëherë një bombulë që nuk është pronë e juaj

Bombulat bosh duhet të kthehen te shoqëria Messer sa më shpejt të jetë e mundur.

Trajtimi i bombulave

Shmangni sa më shumë të jetë e mundur trajtimin manual të bombulave të gazit; rekomandohet që në vend të kësaj të përdorni mjete ndihmëse mekanike (trailera për bombula gazi, pirunë, etj.).

Sigurohuni që bombula e gazit nën presion të jetë e siguruar siç duhet në pajisjen e trajtimit mekanik dhe që ventili i bombulës të jetë i mbyllur. Para se të transportoni bombulat e gazit nën presion, shkëputni të gjitha pajisjet e bashkangjitura (siç janë rregullatorët e presionit) dhe vendosni kapakun e pajisur për mbrojtjen e ventilit. Kushtojini vëmendje kushteve të ambientit. Për shembull, nëse bombulat janë të lagura, të nxehta ose të ftohta, kjo mund të ndikojë negativisht në aftësinë tuaj për t'i trajtuar ato me siguri.

Shpesh bombulat rrotullohen gjatë trajtimit. Kjo bëhet duke balancuar bombulën në këmbë në një kënd të vogël dhe duke e mbajtur atë në pozicion vertikal me një dorë, ndërsa dora tjetër lëviz bombulën përpara duke shtyrë trupin e bombulës.

- Një dorë në kapakun e mbrojtjes së ventilit (ose, në raste të jashtëzakonshme, në qafën e bombulës

nëse bombula rrotullohet pa kapakun mbrojtës të ventilit).

- Dora e dytë vendoset në trupin e bombulës.
- Pozicion pothuajse vertikal.
- Lëvizni ngadalë dhe në mënyrë të kontrolluar.

Mos vraponi. Mos i rrotulloni bombulat e gazit nepër shkallë ose mbi sipërfaqe të pa sheshuara, të buta.

Mos e rrotulloni asnjëherë bombulën horizontalisht në shesh. Kjo mund të dëmtojë ventilin e bombulës, ose mund të hapet ventili nëse bombula përplaset në një pengesë. Për më tepër, sipërfaqet e ashpërta mund të dëmtojnë etiketën dhe ngjyrën e bombulës.

Mos rrotulloni asnjëherë dy bombula në të njëjtën kohë.

Mos provoni asnjëherë të kapni një bombulë gazi që është duke u rrëzuar. Bombulat e gazit janë projektuar për t'ë përbaluar një ndikimi të tillë. Në vend të kësaj, lëreni bombulën e gazit të bjerë dhe të largohet në mënyrë të sigurt.



Ngritja manuale e bombulave të gazit

Përpara se të ngrini një bombul të rrëzuar, kontrolloni nëse është e mundur t'i afroheni bombulës pa rrezikuar veten. Sigurohuni që bombula e gazit dhe ventili i bombulës të mos jenë dëmtuar ose duke rrjedhur.

Sigurohuni që të mos ketë rrezik të pengoheni ose rrëzoheni në afërsi të bombulës së gazit.

Vendosni pajisjet tuaja mbrojtëse personale (këpucë dhe doreza).

Shtrëngoni qafën e bombulës së gazit ose kapakun mbrojtës të ventililit me të dyja duart. mos e ngrini asnjëherë bombulën e gazit nga ventili i bombulës.

Duke e mbajtur shpinën drejt, ngrini bombulën, duke ecur përpara. Pasi bombula e gazit të jetë vendosur në pozicion vertikal, siguroni bombulën.

Paleta individuale të bombulave të gazit

Zakonisht bombulat e gazit transportohen dhe magazinohen në paleta të bombulave, të dizajnuara posaçërisht për këtë qëllim. Çdo herë që doni të hiqni një bombul gazit nga paleta ose të vendosni një bombul përsëri në paletë, kushtojini vëmendje rreziqeve që përfshihen në mënyrë që të shmangni dëmtimet.

Shtyllat mbajtëse të paletës mund të bien nëse nuk sigurohen. Bombulat e gazit mund të rrëshqasin mbrapsht kur ato janë duke qëndruar në pozicion të pjerrët.

Bëni kujdes që të mos zini gishtat midis bombulave.

Vishni veshje të përshtatshme mbrojtëse.





Ju mund të kërkonti **udhëzues** shtesë **xhepi për sigurinë** në faqen tonë të Internetit ose t'i merrni ato direkt nga ekspertët tanë.

Ky udhëzues xhepi shoqërohet me një tutorial në internet.



E rëndësishme

Ky udhëzues xhepi përmban vetëm informacione të përgjithshme. Nuk zëvendëson trajnimet dhe nuk është menduar si i tillë. Messer nuk mban përgjegjësi për informacionet që përmban kjo broshurë.

MESSER

Gases for Life